



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.5888/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Hysni Ismaili, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.H.K., nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve, Studio Ligjore & Financiare “K. & A.”, me seli në P., kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, me seli në P., lidhur me çështjen kompensim i dy pagave jubilarë, me vlerë të kontestit 1.166€, jashtë seancës gjyqësore, me datë 27.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses F.H.K., nga P., dhe **DETYROHET** e paditura SHSKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në P., që paditëses, t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të dy pagave mujore të saj, shumën prej 554.03€, e në shumë të përgjithshme prej 1,108.06€.

II. DETYROHET e paditura që paditëses, shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 16.11.2022 (data e paraqitjes së padisë në gjykatë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, në lartësi prej 124€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

III. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për kompensim të jubileut, në shumën prej 57.94€, **SI E PABAZUAR**.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë me datë 16.11.2022, ka parashtruar padi dhe e ka precizuar atë me parashtrësën e datës 01.02.2024, me objekt kontesti kompensimin e dy pagave jubilarë, e drejtë kjo e garantuar me Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar me datën 11.06.2018, konform nenit 17.

I autorizuari i paditëses në padi, ka theksuar se paditësja është e punësuar në Klinikën e Pulmologjisë në QKUK, në pozitën Infermiere, sipas kontratës së punës, dhe ka 20 vite përvojë pune te punëdhënësi i njëjtë. I propozon gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditëses në emër të dy pagave jubilarë t'ia paguajë shumën nga 583€ e në shumë të përgjithshme prej 1,166, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

E paditura me përgjigje në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se paditësja këtë të drejtë e ka realizuar në Procedurë Përmbarimore, ku e paditura e ka përmbaruar në tërësi obligimin e saj duke bërë pagesën e pagave jubilarë për paditësen, duke i bashkangjitur edhe një konkluzion me shenjë P.nr.955/20, të datës 15.09.2022, andaj në këtë kuptim ka kërkuar nga gjykata që padinë e paditëses, ta refuzon në tërësi si të palejueshme dhe të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi se kërkesëpadia e paditëses është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe se palët ndërgjyqëse kanë të themeluar marrëdhënie pune sipas Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar, të datës 12.10.2012, ndërsa nga Lista e pagave lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se paga mujore e paditëses është në lartësi prej 554.03€, e që dy paga të shpërblimit jubilar arrijnë shumën prej 1,108.06€. Po ashtu edhe nga vërtetimi i datës 30.11.2023, i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, gjykata gjeti se paditësja në vitin 2023 ka arritur 23 vite, 2 muaj e 24 ditë përvojë punë e që rrjedhimisht kuptohet se 20 vite të përvojës në punë i ka arritur në vitin 2020, në kohën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, e datës 11.06.2018.

Gjykata gjeti se Kontrata Kolektive Sektoriale ka hyrë në fuqi nga 11.06.2018 dhe e njëjta është e zbatueshme dhe në nenin 17 par. 3 të kësaj kontrate është paraparë edhe shpërblimi jubilar. Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si të tillë e ka aprovuar atë, në shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara dhe faktet e provuara rezulton se e paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, i ka mbetur borxh paditëses për pagesën e dy pagave në emër të shpërblimit jubilar, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësja e ka cilësinë e kreditores ndërsa e paditura cilësinë e debitorës.

Sipas dispozitës së nenit 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) parashihet se “kreditore në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditëses me aplikimin e kësaj dispozite ligjore dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditëses t’ia kompensojë borxhin në shumën e gjykuar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, të datës 11.06.2018, ndërsa shuma e shpërblimit jubilar dhe stazhi i punës vërtetohen nga provat që gjendet në shkresat e lëndës.

Lidhur me kundërshtimet e të paditurës dhënë në përgjigje në padi, se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet për shkak se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, ngase e njëjta ka realizuar këtë kërkesë në procedurë përmbartimore, ku QKUK ka përmbushur në tërësi detyrimin e saj për pagesë të pagave jubilarë për paditësen, janë të pabazuara ngase konkluzioni P.nr.955/20, të datës 15.09.2022, i bashkangjitur nga e paditura si provë bashkë me përgjigjen në padi, nuk dëshmojnë se ka të bëjë me kërkesën e paditëses për pagesë të dy pagave jubilarë.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadiës së paditëses gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me pagesën shtesë për shpërblim jubilar, ngase nga lista e pagave gjykata gjeti se paditësja realizon pagë mujore prej 554.03€ e jo 583€ sa ka pretenduar me padi, andaj vendosi që ta refuzojë pjesën përtej shumës së aprovuar në pikën I të dispozitivit, në lartësi prej 57.94€.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, ku është paraparë se Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitorin, përpos borxhit kryesor edhe kamatën, lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit. Ndërsa si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e ushtrimit të padisë në gjykatë datë 16.11.2022.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452 e lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses për padi shumën 104 € dhe për taksë gjyqësore shumën 20€, (sipas nr. tarifor 6 dhe 7, të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës). Gjykata me rastin e vendosjes

lidhur me shpenzimet e procedurës, i mori parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme dhe që janë krijuar për këtë procedurë.

Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.5888/2022 datë 27.02.2025

Gjyqtari
Hysni Ismaili

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.